



Pranuar / Dorezuar Prijmljeno/Prodato Received/Delivery	20.12.2021	viti god year	
Organ /Njësia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMBSHCK	6238/2021		113



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.927/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca - kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Arben Mehmeti-anëtar me Çlirim Zeka - Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit me numër A.nr.1599/21, të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.453/2021 të datës 28.05.2021 të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi Rr. "Ibrahim Mazreku" nr. 24 Prishtinë, kundër organit të punësimit Komunes së Prishtinës, në çështjen juridike "Kërkesë nga Marrëdhënia e Punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 17.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.453/2021 e datës 28.05.2021 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në pozitën e punës "Zyrtare e Lartë Ligjore" në Komunën e Prishtinës, me datë 28.05.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 2673/2021 të regjistruar me A.nr.453/2021, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të moszbatimit të nenit 8 paragrafi 1 dhe nenit 29 paragrafi 2 të Ligjit Nr.04/L-157 për Avokaturën Shtetërore, si dhe nenin 3 paragrafi 2 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, me rastin e sistemimit në pozitën e Zyrtares Ligjore sipas Vendimit 01 nr.031-13761 të datës 19.01.2016 për Organizimin, kompetencat, përgjegjësit dhe sistematizimin e vendeve të punës në administratën e Komunes se Prishtinës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 09.06.2021, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të organi i punësimit, ndërsa me datë 17.06.2021 Këshilli ka pranuar nga Komuna e Prishtinës përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 12.07.2021, përmes shkresës me numër protokoll 3640/2021, ka njoftuar ankuesen se në mungesë të kuorunit nuk mundë të



shqyrtoj dhe vendose lidhur me ankesën A.nr.453/2021, të datës 28.05.2021, dhe të njëjtën e ka udhëzuar që t'i drejtohet Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesja, në mungesë të vendimmarrjes në Këshill, të njëjtën kohë ka hapur konflikt administrative, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, përmes Aktgjykimit A.nr.1599/2021, ka aprovuar kërkesë padinë e paditëses, me të cilin ka anuluar njoftimin e datës 12.07.2021, dhe e ka obliguar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, që të vendos lidhur me ankesën A.nr.453/2021, të datës 28.05.2021 të parashtruar nga

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën numër protokolli 2673/2021 të regjistruar me A.nr.453/2021, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimin e datës 12.07.2021; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 09.06.2021; Akt Emërimit me nr. 01 nr.112-879 të datës 01.02.2017; Certifikatën për provimin e dhënë të Jurisprudencës me nr. 01 nr.152-1-154/2011 të datës 26.12.2012; Vërtetimin me numër. 01. Nr. 119-50 të datës 19.05.2016; Përgjigjen në ankesë e datës 17.06.2021; Vendimin për organizimin, kompetencat, përgjegjësitë dhe sistematizimin e vendeve të punës së administratës komunale me numër 01-031-13761 të datës 19.01.2016; E-mailin nga D.S. për E.Sh. të datës 18.11.2021; E-mailin nga A.M. për D.S. të datës 18.11.2021; dhe Aktgjykimin me numër A.nr.1599/21 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesja dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankueses
është e palejuar, sepse:

Bazuar në shkresat e lëndës, rezulton se Kryetari i Komunës së Prishtinës, me datë 19.01.2016 ka nxjerr Vendimin 01 nr.031-13761-19.01.2016 për Organizimin, kompetencat, përgjegjësit dhe sistematizimin e vendeve të punës në administratën e Komunës së Prishtinës. Si rrjedhojë e këtij vendimi, ankuesja me datë 01.02.2017 përmes Akt Emërimit 01-nr.112/879 është sistemuar në pozitën e punës Zyrtare e lartë Ligjore në Sektorin Ligjor në kuadër të Kabinetit të Kryetarit të Komunës. Me rastin e nënshkrimit të Akt Emërimit, e njëjta është pajtuar me kushtet e punësimit në pozitën përkatëse, dhe se nuk ka parashtruar ankesë.

Ankuesja, me datë 28.05.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të moszbatimit të nenit 8 paragrafi 1 dhe nenit 29 paragrafi 2 të Ligjit Nr.04/L-157 për Avokaturën Shtetërore, i publikuar në Gazetë Zyrtare me datë 08.04.2013, lidhur me sistemin e ankueses në pozitën e Avokates Shtetërore.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave konstaton se ankesa A.nr.453/2021 e datës 28.05.2021 është parashtruar jashtë afatit ligjor prej 30 ditësh siç ka qenë e përcaktuar me dispozitat e Ligjit Nr.02/L-28 për Procedurën Administrative, përkatësisht nenin 130 paragrafi 1 ku përcaktohej se: *Ankimi administrativ bëhet brenda 30 ditësh nga dita kur: a) ankuesi ka marrë njoftim për aktin ose për refuzimin për të nxjerrë aktin.*

Pra, duke marr parasysh se Ligjit Nr.04/L-157 për Avokaturën Shtetërore, ka hyrë në fuqi në vitin 2013, dhe pretendimet ankimore të ankueses lidhen me moszbatimin e dispozitave të këtij ligji, Kolegji vlerëson se ankuesja është dashur të parashtronte ankesë brenda afatit prej 30 ditësh nga data



e nxjerrjes se Vendimit 01 nr.031-13761 të datës 19.01.2016 për Organizimin, kompetencat, përgjegjësit dhe sistematizimin e vendeve të punës në administratën e Komunës së Prishtinës, apo nga data 01.02.2017 kur të njëjtës i është ofruar për nënshkrim Akt Emërimi për pozitën e punës Zyrtare e lartë Ligjore.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, në shkresa të lëndës nuk ka gjetur ndonjë kërkesë apo veprim tjetër të mëvonshëm të parashtruar nga ankuesja për organin e punësimit, me çka do të mund të trajtohej ligjshmëria e veprimit të organit të punësimit apo heshtja administrative, siç parashihet me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-144 për Zyrtaret Publikë, përkatësisht nenin 24 paragrafi 3 ku përcaktohet se: *Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji, si dhe dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenin 125 paragrafi 1 ku përcaktohet se: Përpos nëse është paraparë ndryshe me ligj, ankesa mund të parashtrohet kundër një akti administrativ apo ndaj mosveprimit të organit publik brenda afatit të përcaktuar për përfundimin e procedurës administrative (në vijim: "heshtja administrative").*


Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.927/2021

Çlirim Zeka


Procesmbajtës



Jeton Koca
Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative, Gjyqtarës Anita Nikçi Morina
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës,
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Prishtinës; dhe
- Arkivit të KPMSHC- së.